

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	09.06.2020	Vënije në dispozicion dokumentacioni dhe informacin për se nuk mund të regjistrohet në provim shteti.	10.06.2020	Për shka të problemeve të konstatuara në diplomë, UFSH si institucion jo përgjegjës për konfirmimin e vlefshmërisë së diplomës, e ka përcjellë informacionin pranë institucioneve përkatëse.	E plotë	S'ka tarifë
2.	09.06.2020	Kërkesë mbi informacion mbi datën në të cilën ka dorëzuar certifikatën punëmarrsja.	10.06.2020	Vënija në dispozicion e informacionit.	E plotë	S'ka tarifë
3.	10.06.2020	Informacion në lidhje me drejtuesin teknik actual të subjektit "..."	11.06.2020	Vënije në dispozicion e informacionit.	E plotë	S'ka tarifë
4.	21.07.2020	Kërkesë për vënije në dispozicion të gjeneraliteteve të disa farmacistëve.	03.09.2020	Informacioni i kërkuar është objekt i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vihet në dispozicion I pjesshëm, duke I dhënë informacion	E pjesshme	S'ka tarifë

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				mbi, nr e anëtarësisë dhe subjektin ku ushtrojnë profesionin.		
5.	28.07.2020	Informacion mbi arsyet e mospranimit të dokumentacionit për anëtarësim.	29.07.2020	Arsyeja e refuzimit paraqitja e dy diplomave per farmaci me data te ndryshme leshimi. Zgjidhja e problematikës pranë institucioneve kompetente dhe më pas paraqitja pranë UFSH për anëtarësim.	E plotë	S'ka tarifë
6.	25.11.2020	Kërkesë për informacion në lidhje me listën e barnave që kanë qenë në dispozicion për sistemin spitalor shtetëror, për periudhën janar – shkurt 2020	27.11.2020	UFSH nuk e disponon informacionin e kërkuar. Adresimin e kërkesës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.	E plotë	S'ka tarifë
7.	17.12.2020	Informacion si do procedohet për pajisjen me leje ushtrimi profesioni në funksionin e drejtuesit teknik.	21.12.2020	Adresimi për dorëzimin e dokumentacionit pranë Këshillit Rajonal përkatës.	E plotë	S'ka tarifë
8.	27.01.2021	Kërkesë për informacion në lidhje me situatën e farmacistit	29.01.2021	Venije në dispozicion e informacionit.	E plotë	S'ka tarifë
9.	27.01.2021	Informacion nëse shtetasit X dhe Y janë certifikuar/licencuar nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, për ushtrim aktiviteti farmacist/ndihmës farmacist,	27.01.2021	Asnjë nga këta shtetas nuk është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, si dhe nuk rezultojnë të jenë të regjistruar në regjistrin e ndihmës farmacistëve, ç'ka tregon se këta shtetas nuk e gëzojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit dhe as të ndihmës farmacistit.	E plotë	S'ka tarifë

10.	04.03.2021	Informacion në lidhje me numrin total të farmacistëve të licencuar për çdo vit për periudhën 2015-2020.	16.03.2021	Në vitin 2015 kanë qenë 2200 farmacistë aktivë (që ushtronin profesionin), në vitin 2016, 2268 farmacistë aktivë, në vitin 2017, 2579 farmacistë aktivë, në vitin 2018, 2888 farmacistë aktivë, në vitin 2019, 2789 farmacistë aktivë dhe në vitin 2020, 2878 farmacistë aktivë. Në Urdhrin e Farmacistëve janë anëtarësuar në vitin 2015, 227 anëtarë të rinj, në vitin 2016, 258 anëtarë të rinj, në vitin 2017, 259 anëtarë të rinj, në vitin 2018, 247 anëtarë të rinj, në vitin 2019, 256 anëtarë të rinj dhe në vitin 2020, 206 anëtarë të rinj.	E plotë	S'ka tarifë
11.	12.05.2021	Informacion mbi arsyet e mospranimit të dokumentacionit për anëtarësim.	18.06.2021	Adresim për zgjidhjen e problematikës që ka me diplomën dhe më pas paraqitja pranë UFSH-së për anëtarësim.	E plotë	S'ka tarifë
12.	05.07.2021	Kerkese per arsyet e refuzimit te licencimit.	13.07.2021	Nuk ploteson kriteret, ne baze te nenit 40 te ligjit te barnave, per te gene drejtuese teknike ne farmaci.	E plote	S'ka tarife
13.	12.07.2021	Kerkese per informacion nëse është lëshuar prej Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë certifikata Nr. _____, datë _____ e vlefshme deri më _____ për shtetasin	13.07.2021	Pranë Urdhrit të Farmacistëve nuk figuron i regjistruar asnjë farmacist me emrin _____.	E plotë	S'ka tarife
14.	30.07.2021	Kërkesë për informacion në lidhje me arsyet e mos regjistrimit në provim	23.09.2021	Përgjigjja i është kthyer me vonese për shkak se ka pasur mungese të dokumentit në aplikim. Kërkesa është regjistruar si kërkesë për informacion	E plotë	S'ka tarife

		shteti në profesionin e farmacistit.		në bazë të lëndës, por në trajtim ka qenë ankesë. Pas verifikimeve rezultojnë që diploma e të interesuarës ka problem, pasi është diplomuar tek Universiteti Kristal.		
15.	06.08.2021	Kërkesë për gjeneralitetet e shtetasit _____	24.08.2021	Pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë nuk rezultojnë i regjistruar asnjë anëtar me emrin _____	E plotë	S'ka tarife
16.	29.09.2021	Kërkesë për informacion në lidhje me elementët që përmban certifikata e Urdhrit të Farmacistëve.	29.09.2021	Farmacisti pajiset me certifikatën origjinale dhe një fotokopje të vulosur nga institucioni. Certifikata e lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve përmban këto elementë: Numrin e anëtarësisë, i cili është numër unik për çdo farmacist, i patjetërsueshëm dhe i patjetërsueshëm; Datën e lëshimit të certifikatës; Funksionin që kryen farmacisti, farmacist i punësuar apo drejtues teknik; Subjektin në të cilin farmacisti ushtron profesionin; Afatin e vlefshmërisë; Firmën e Presidentit; Vulën e institucionit.	E plotë	S'ka tarife
17.	11.10.2021	Kërkesë me e-mail për të kërkuar informacion në lidhje me numrin e përgjithshëm të antarëve që ka Urdhri., të detajuar sipas pozicioneve.	13.10.2021	Pranë UFSH figurojnë që ushtrojnë profesionin e farmacistit aktualisht 2968 farmacistë. Nga të cilët, 45 janë të punësuar në institucione shtetërore, 2612 janë të punësuar në farmaci si drejtues teknik apo farmacistë, 33	E plotë	S'ka tarife

				<p>janë të punësuar në prodhues farmaceutik, 155 janë të punësuar në importues dhe shpërndarës farmaceutik dhe 123 janë të punësuar në farmaci spitalore shtetërore. Farmacistë spitalore private trajtohen si farmacistë private dhe janë të përfshira në numrin 2612. Gjithashtu në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë profesionin e ndihmës farmacistit pranë agjencive farmaceutike edhe 86 ndihmës farmacistë.</p>		
18.	18.10.2021	Kërkesë për informacion në lidhje me provimin e shtetit, nëse mund të regjistrohet.	01.11.2021	Plotësinimin e kërkesës me kopje të regjistrimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.	E plotë	Ska tarifë
19.	02.11.2021	Kërkesë për vënie në dispozicion të një kopje të regjistrimit të kërkesave.	08.11.2021	Vënie në dispozicion të informacionit	E plotë	Ska tarifë
20.	14.01.2022	Kërkesë nëse pasaktësia e datës së diplomës ndikon për të marrë pjesë në provimin e shtetit.	14.02.2022	Kthim përgjigje dhe drejtimin pranë institucioneve kompetente për zgjidhjen e pasaktësisë në lidhje me diplomën (mos rakordimit të datës së diplomimit), dhe më pas dorëzimi pranë Urdhrit të Farmacistëve të gjithë dokumentacionit të plotë dhe të rregullt në mënyrë që të vijojnë procedurat e regjistrimit për provimin e shtetit në sezonin e ardhshëm.	E plotë	Ska tarifë

21.	20.04.2022	Kërkesë në lidhje me numrin e ALUMNI të regjistruar pranë UFSH-së për viteti 2020-2021	19.05.2022	Vënije në dispozicion të informacionit (pas përpunimit pasi ka qenë i vështirë identifikimi, gjë e cila i është bërë me dije kërkuesit paraprakisht)	E plotë	Ska tarifë
22.	12.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me marzhin dhe fitimin e një farmacie në qytetin e Korcës.	12.08.2022	Kthim përgjigje. 02.09.2022 plotësim i kërkesës për informacion. Objekti i veprimtarisë së UFSH-së, nuk lidhet me përcaktimin e marzhit të tregëtitmit të barit dhe as me gjurmueshmërin e lëvizjes së tij. Aspekti i tregëtimit të barit përcaktohet në ligjin « Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH ».	E pjesshme	Ska tarifë
23.	06.09.2022	Kerkese në lidhje me suplementet mjekësore që shiten në television. 1- Çfarë duhet të bëjnë farmacistët në lidhje me barnat që kërkohen pa recetë? 2. Si ecin barnat që iu bëhet reklamë në television? A ka konsumim të gjërë të tyre?	07.09.2022	Suplementet ose shtesat ushqimore dhe barnat nuk janë e njëjta gjë. Referuar ligjit për barnat dhe shërbimin farmaceutik si dhe Kodit Etik Deontologjik, barnat që tregëtohen në Farmaci ndahen në barna që tregëtohen vetëm me recetë mjekësor dhe barna OTC për të cilat nuk ka lëshohet recetë. Po ashtu referuar ligjit, publiciteti i barnave lejohet vetëm për barnat OTC. Rregullat për publicitetin e barnave miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, në përputhje me hollësitë e paraqitura në përmbledhjen e karakteristikave të produktit. Miratimi i publicitetit të	E pjesshme	Ska tarifë

				<p>barnave kryhet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p> <p>Në lidhje me të dhënat mbi konsumin e barnave, këto të dhëna nuk disponohen nga Urdhri i Farmacistëve pasi nuk janë objekt i veprimtarisë së tij, prandaj ju lutemi drejtohuni pranë Agjencia Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Ndërsa suplementet regjistrohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.</p>		
24.	13.09.2022	Informacion në lidhje me numrin e punëmarrësve që u ka përfunduar marrëdhënia e punës përgjatë viteve 2017-2022.	15.09.2022	Vënije në dispozicion e informacionit.	E plotë	Ska tarifë
25.	21.10.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me vendin e ushtrimit të profesionit të një anëtari të UFSH-së në qytetin e Elbasanit.	26.10.2022	Vënije në dispozicion e informacionit.	E plotë	Ska tarifë
26.	24.01.2023	Kerkese per informacion në lidhje me të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit të një shtetasi.	25.01.2023	Vënje në dispozicion e informacionit	E plotë	Ska tarifë
27.	24.04.2023	Kerkese per informacion në lidhje me të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit të një shtetasi.	24.04.2023	Vënje në dispozicion e informacionit.	E plotë	Ska tarifë

28.	08.06.2023	Kërkesë për informacion, sa Farmaci ka në të gjithë Shqipërinë.	13.06.2023	Urdhri i Farmacistëve ben regjistrimin e farmacistëve si individë dhe jo të farmacive si subjekte. Regjistrimi i farmacive si subjekte dhe licencimi i tyre, kryhet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit. Duke u nisur nga numri i farmacistëve drejtues teknik të regjistruar pranë Urdhrit, në Shqipëri mund të jenë rreth 1500 farmaci, por për numër më të saktë të tyre, ju lutemi drejtohuni pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.	E plotë	Ska tarifë
29.	09.10.2023	Kërkesë për informacion kush figuron drejtues teknik dhe farmacist i punësuar në subjektin FIRST AID, me Nipt L39024501G	11.10.2023	Në subjektin farmaci FIRST AID, me Nipt L39024501G, në pronësi të shtetasës J. Gj, me adresë <i>Lagjja Mustafa Matohiti, Rr. Ali Pashe Tepelena, Godine 1 kateshe përball Raiffaisen Bank, Tepelenë</i> , prej datës 29.07.2020, figuron i regjistruar në funksionin e drejtuesit teknik, farmacisti E. J me numër anëtarësi 3171. Aktualisht pranë këtij subjekti nuk figuron i punësuar asnjë farmacist tjetër. Bashkëngjitur gjeni kopje të certifikatës së lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë për farmacistin E. J.	E plotë	Ska tarifë
30.	19.12.2023	Kërkohet informacion mbi: 1. A gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë barnat:	27.12.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj të ardhur pranë institucionit tonë më datë 19.12.2023, ju informojmë se objekti i veprimtarisë së Urdhrit të	E plotë	Ska tarifë

		<p>DARA rd g l cl LENALIDOMIDE 25 mg 2. Nëse këto barna gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë a janë në listën e barnave të rimbursueshme?</p>		<p>Farmacistëve të Shqipërisë është ruajtja e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe zbatimi i rregullave të moralit dhe etikës profesionale të farmacistëve. Institucioni i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore është Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p> <p>Duke qenë se Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë nuk e disponon informacionin e kërkuar, nëse barnat DARA rd g l cl dhe LENALIDOMIDE 25 mg gjenden të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, po ia adreson kërkesën tuaj, Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p> <p>Në lidhje me listën e barnave me rimbursim, ju bëjme me dije se dhe lista e barnave të rimbursueshme nuk është objekt veprimtarie i Urdhrit të Farmacistëve, por është e miratuar me vendimin Nr. 196, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe barnat e sipërpërmendur nuk rezultojnë të jenë pjesë e listës së rimbursueshme.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

30.	17.01.2024	Kërkohet informacion mbi certifikatat e farmacistëve të punësuar dhe drejtues teknik, që figurojnë në regjistrat e UFSH, në subjektin Farmaci 24, me Nipt L98309501N, me adresë Lagjja Beslidhja, Lezhë.	26.01.2024	Në regjistrat e Urdhrit të Farmacistëve aktualisht nuk figuron asnjë farmacist i punësuar apo drejtues teknik, për subjektin, Farmaci 24, me Nipt L98309501N.	E plotë	Ska tarifë
31.	21.02.2024	Kërkesë për informacion, Jam antarsuar tek Urdhri i Farmacistit në fund dhjetori 2023 dhe do doja të dija cilat janë detyrimet e mia ndaj Urdhrit për një vit dhe afatet kohore.	21.02.2024	Kuotizacioni vjetor i anetareve të UFSH-se është 6000 leke për farmacistin e punësuar dhe 12000 leke për drejtuesin teknik ose 500 leke në muaj për farmacistin e punësuar dhe 1000 leke për drejtuesin teknik. Kuotizacionet paguhen dy herë në vit, në muajin qershor, 6 muajori i parë dhe në muajin dhjetor 6 muajori i dytë, por asnjehere me vonë se muaji mars i vitit pasardhës.	E plotë	Ska tarifë
32.	23.02.2024	<i>Në bazë të ligjit për Të Drejtën e Informimit me numër 119/2014 ju dërgojmë këtë kërkesë për informacion:</i> A keni ju të dhëna për numrin e farmacive private dhe publike në Republikën e Shqipërisë? A keni kryer ju monitorime	29.02.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë për sa më poshtë vijon: 1. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në mbështetje të ligjit 9150, datë 30.10.2003, jep dhe heq të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit. Informacionin e saktë në lidhje me numrin e subjekteve farmaceutike e disponon Qendra	E plotë	Ska tarifë

		<p>mbi veprimtarinë e farmacive? Nëse po, çfarë problematikash keni vërejtur?</p> <p>A keni ju dijeni për farmaci që ushtojnë aktivitetin e tyre pranë institucioneve shëndetësore publike?</p> <p>A keni ju dijeni për barna që tregtohen në farmaci nën çmimin e përcaktuar në pullën fiskale ose paketimin e jashtëm?</p> <p>Cilat janë masat që keni marrë?</p>		<p>Kombëtare e Biznesit, si institucioni përgjegjës për licencimin e subjekteve farmaceutike.</p> <p>2. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në mbështetje të ligjit 9150, datë 30.10.2003, kryen mbikëqyrje në subjektet farmaceutike, por vetëm për sa i përket aspektit të zbatimit të detyrave profesionale të farmacistëve në përputhje me shkencat farmaceutike, ligjin dhe Kodin Etik Deontologjik. Një nga problematikat më shqetësuese që Urdhri ka evidentuar, shqetësim të cilin e ka ngritur dhe në struktura të tjera përgjegjëse, në takimet që ka zhvilluar me përfaqësues të institucioneve, është dhënia e shërbimit farmaceutik nga individë që nuk e kanë këtë të drejtë.</p> <p>3. Legjislacioni aktual nuk e ndalon hapjen e një farmacie pranë institucioneve shëndetësore publike.</p> <p>4. Urdhri i Farmacistëve nuk disponon informacion në mënyrë zyrtare në lidhje me tregëtimin e barnave nën çmimin e përcaktuar. Referuar ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe Shërbimin farmaceutike”, kontrolli i barnave dhe pajisjeve mjekësore,</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				respektimi i çmimit, si dhe inspektimi i veprimtarive në fushën farmaceutike dhe farmakovigjilencën (evidentimi i efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave) janë objekt i veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.		
33.	22.04.2024	Kërkohet informacion mbi: 1. A gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë bari STELARA 90 mg? 2. Sa wshwtw kostoja e tij? Nëse nuk gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë sa është kostoja për tu vendosur në dispozicion të një të burgosuri.	17.05.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se objekti i veprimtarisë së Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë është ruajtja e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe zbatimi i rregullave të moralit dhe etikës profesionale të farmacistëve. Institucioni i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore është Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Duke qenë se Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë nuk e disponon informacionin e kërkuar, nëse bari STELARA 90 mg, gjendet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sa është kostoja e tij dhe nëse nuk gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë sa është kostoja për tu vendosur në dispozicion të një të burgosuri, ju lutemi që kërkesën tuaj t'ia adresoni	E plotë	Ska tarifë

				Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.		
34.	16.05.2024	<p><i>Në bazë të ligjit për Të Drejtën e Informimit me numër 119/2014 ju dërgojmë këtë kërkesë për informacion:</i></p> <p>Sa është numri i farmacistëve aktiv?</p> <p>Sa prej tyre janë në pozicionin “Drejtues Teknik”?</p> <p>Sa “Drejtues Teknik” janë të punësuar?</p> <p>Sa farmacistë janë të punësuar në institucione spitalore shtetërore publike dhe private?</p> <p>Sa farmacistë janë “Drejtues Teknik” në importues, shpërndarës dhe prodhues farmaceutik?</p> <p>Sa farmacistë janë që prodhojnë produkte farmaceutike?</p>	22.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju informojmë për sa më poshtë vijon:</p> <p>Aktualisht, referuar të dhënave në regjistrin themeltar të UFSH, të datës 20.05.2024, pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë figurojnë 3190 farmacistë aktivë (që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë). Nga këta, 1758 farmacistë ushtrojnë funksionin e drejtuesit teknik.</p> <p>131 farmacistë ushtrojnë profesionin si të punësuar në institucione spitalore, shtetërore apo private.</p> <p>130 farmacistë ushtrojnë profesionin e farmacistit në funksionin e drejtuesit teknik pranë importues, shpërndarës dhe prodhues farmaceutikë dhe 26 farmacistë ushtrojnë profesionin si të punësuar në kompani prodhuese në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në lidhje me numrin e drejtuesve teknik të punësuar, Urdhri i Farmacistëve nuk e disponon informacionin se sa drejtues teknik janë të punësuar dhe sa drejtuese teknik janë të vetpunësuar.</p>	E plotë	Ska tarifë

35.	23.05.2024	<p>Kerkese per te vendosur ne dispozicion edhe disa te dhena si me poshte:</p> <p>1. Sa eshte nr i drejtuesve teknike dhe farmacisteve te punesuar ne rajonin e Tiranes?</p> <p>a) Sa drejtues teknik jane ne importues, shperndares ne Tirane?</p> <p>b) Sa drejtues teknik jane ne rrjetin e hapur ne Tirane?</p> <p>2. Sa eshte nr i farmacisteve drejtues teknik ne Shqiperi?</p> <p>a) Sa eshte nr i farmacisteve drejtues teknik te punesuar ne farmcaci te rrjetit te hapur?</p> <p>b) Sa eshte nr i drejtuesve teknik ne Shqiperi?</p> <p>c) Sa eshte nr i drejtuesve teknik te punesuar ne importues dhe shperndares?</p>	10.06.2024	<p>Numri i drejtuesve teknike dhe farmacisteve te punesuar ne rajonin e Tiranes eshte 1750.</p> <p>Numri i drejtuesve teknike ne importues, shperndares ne Tirane eshte 101.</p> <p>Numri i drejtuesve teknike ne rrjetin e hapur ne Tirane eshte 744.</p> <p>Numri i farmacisteve drejtues teknik ne Shqiperi eshte 1758.</p> <p>Numri i drejtuesve teknik ne Shqiperi qe ushtrojne profesionin ne Farmaci eshte 1627.</p> <p>Numri i drejtuesve teknik ne Shqiperi te punesuar ne importues dhe shperndares farmaceutik eshte 121.</p>	E plotë	Ska tarifë
36.	06.09.2024	<p>Në përputhje me aktet ligjore të ngarkuara në faqen zyrtare të Urdhrit të Farmacistit, ju lutem për dhënien e informacionit në lidhje me profesionin</p>	06.09.2024	<p>Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë se një farmacist që ushtron funksionin e drejtuesit teknik si i vetpunësuar mund të punojë dhe në një subjekt tjetër.</p>	E plotë	Ska tarifë

		"Farmacist", Nëse një Farmacist i vetpunësuar dhe drejtues teknik, që e menaxhon farmacinë e tij personalisht pa të punësuar tjetër, a mund të punojë dhe një punë tjetër full-time në shtet në pozicion tjetër që nuk ka të bëjë me rolin e farmacistit?		Nëse farmacia nuk ka një farmacist tjetër të punësuar, atehere si do ta ushtrojë veprimtarinë? Sa orë do të qëndrojë hapur? Kush do të punojë në Farmaci në kohën që ju do të punoni në subjektin tjetër? Farmacia është institucion i kujdesit shëndetësor dhe duhet të garantojë për qytetarët ofrimin e një shërbimi Farmaceutik të sigurt dhe në përputhje me kërkesat dhe normat e etikës mjekësor edhe Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare.																				
37.	28.03.2025	Duke uruar qe ky email t'ju gjeje mire, ju paraqes kerkesen time per disa informacione per qellime studimore lidhur me profesionistet e farmacise ne vendin tone, si me poshte: Të dhëna për një periudhë të qëndrueshme prej 10 vitesh (2014-2024). Variablat e nevojshme janë si më poshtë: • Numri i farmacistëve që diplomohen çdo vit.	28.03.2025	Ne pergjigje te emailit tuaj, po ju dergojme informacionin e kerkuar si meposhte: Numri i farmaciteve qe diplomohen	E plotë	Ska tarifë																		
				<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Nr. i te diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2015</td> <td>209</td> </tr> <tr> <td>2016</td> <td>362</td> </tr> <tr> <td>2017</td> <td>283</td> </tr> <tr> <td>2018</td> <td>290</td> </tr> <tr> <td>2019</td> <td>238</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>167</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>228</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>174</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Nr. i te diplomuarve	2015	209	2016	362	2017	283	2018	290	2019	238	2020	167	2021	228	2022	174		
Viti	Nr. i te diplomuarve																							
2015	209																							
2016	362																							
2017	283																							
2018	290																							
2019	238																							
2020	167																							
2021	228																							
2022	174																							

	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i farmacistëve që migrojnë çdo vit. • Numri i farmacistëve që punojnë në farmaci. • Numri i farmacistëve që punojnë në Shqipëri, por jo në farmaci (disa punojnë në institucione publike ose kompani farmaceutike si menaxherë ose në marketing). • Numri i të diplomuarve në farmaci që nuk punojnë fare. • Ndarja sipas gjinisë, nëse ka të dhëna për farmacistet që ndalojnë së punuari gjatë periudhës së rritjes së fëmijëve dhe më pas rikthehen në punë më vonë. <p>Do të ishte e preferueshme të kishim dhe një informacion mbi numrat aktuale të farmacistëve që punojnë dhe që nuk punojnë, të ndare sipas gjinisë dhe fashave moshore 10 vjeçare (deri 35 vjeç; >35-45 vjeç; >45-</p>		<table border="1" data-bbox="1100 191 1669 324"> <tr><td>2023</td><td>119</td><td></td></tr> <tr><td>2024</td><td>145</td><td></td></tr> <tr><td>Total</td><td>2215</td><td></td></tr> </table> <p>Numri i farmacistëve që migrojnë çdo vit</p> <table border="1" data-bbox="1100 451 1669 673"> <tr><td>2020</td><td>41</td><td></td></tr> <tr><td>2021</td><td>49</td><td></td></tr> <tr><td>2022</td><td>75</td><td></td></tr> <tr><td>2023</td><td>64</td><td></td></tr> <tr><td>2024</td><td>43</td><td></td></tr> </table> <p>Numri i farmacistëve që punojnë në farmaci</p> <table border="1" data-bbox="1100 885 1965 974"> <thead> <tr><th>Meshkuj</th><th>Femra</th><th>Total</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>606</td><td>2305</td><td>2911</td></tr> </tbody> </table> <p>Numri i farmacistëve që punojnë në Shqipëri, por jo në farmaci</p> <table border="1" data-bbox="1100 1218 1965 1307"> <thead> <tr><th>Meshkuj</th><th>Femra</th><th>Total</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>83</td><td>236</td><td>319</td></tr> </tbody> </table>	2023	119		2024	145		Total	2215		2020	41		2021	49		2022	75		2023	64		2024	43		Meshkuj	Femra	Total	606	2305	2911	Meshkuj	Femra	Total	83	236	319		
2023	119																																								
2024	145																																								
Total	2215																																								
2020	41																																								
2021	49																																								
2022	75																																								
2023	64																																								
2024	43																																								
Meshkuj	Femra	Total																																							
606	2305	2911																																							
Meshkuj	Femra	Total																																							
83	236	319																																							

		55 vjec; >55-65 vjec dhe > 65 vjec).		<p>Numri i farmacisteve te cilet nuk e ushtrojne profesionin per arsye: - daljes ne pension; - largimit jashte vendit; - nuk punojne ne sektorin farmaceutik; - punojne ne institucione shteterore, depo, perfaqesi por pozicioni i punes nuk eshte ne profesionin e farmacistit; - per shkak te lejes se lindjes etj</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Meshkuj</th> <th>Femra</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>242</td> <td>1098</td> <td>1340</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndarja sias fashave moshore 10 vjec</p> <p>Aktiv (qe ushtrojne profesionin)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mosha</th> <th>Meshkuj</th> <th>Femra</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>mbi 65 vjec</td> <td>82</td> <td>194</td> </tr> <tr> <td>55 - 66 vjec</td> <td>57</td> <td>146</td> </tr> <tr> <td>45 - 55 vjec</td> <td>87</td> <td>235</td> </tr> <tr> <td>35 - 45 vjec</td> <td>239</td> <td>874</td> </tr> <tr> <td>deri ne 35 vjec</td> <td>224</td> <td>109</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>689</td> <td>254</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ju informojme se informacionet e mesiperme ju perkasin te dhenave qe Urdhri i Farmacisteve disponon, te perpunuara deri me date 27.03.2025.</p>	Meshkuj	Femra	Total	242	1098	1340	Mosha	Meshkuj	Femra	mbi 65 vjec	82	194	55 - 66 vjec	57	146	45 - 55 vjec	87	235	35 - 45 vjec	239	874	deri ne 35 vjec	224	109	Total	689	254		
Meshkuj	Femra	Total																															
242	1098	1340																															
Mosha	Meshkuj	Femra																															
mbi 65 vjec	82	194																															
55 - 66 vjec	57	146																															
45 - 55 vjec	87	235																															
35 - 45 vjec	239	874																															
deri ne 35 vjec	224	109																															
Total	689	254																															
38.	02.05.2025	Unë jam kolegu juaj	05.05.2025	Ne pergjigje te emailit ju informojme se sipas te dhenave qe ne disponojme	E plotë	Ska tarifë																											

		<p>Jam i regjistruar në “Konferencën e 13 të Shkencave Mjekësore” si lektor me temën “ROLI I FARMACISTIT NË MENAXHIMIN E MJEKIMIT TE HTA” Do të kisha dashur nje informacion për numrin e farmacive aktive ne Shqiperi (Farmaci +Agjenci). Plus kesaj nëse e keni si informacion sa prej tyre jane me kontrate me Fondin.</p> <p>Shpresoj si koleg dhe qytetar i Shqiperise mund ta marr një informacin të tillë.</p>		<p>ne Shqiperi jane rreth 1610 farmaci dhe 78 agjenci farmaceutike. Per nje informacion me te sakte, mund ti referoheni Qendres Kombetare te Biznesit, pasi ai eshte institucioni pergjegjes per regjistrimin e subjekteve farmaceutike. Urdhri i Farmacisteve ben regjistrimin e farmacisteve, jo te subjekteve dhe te dhenat qe ne disponojme dalin nga regjistrimi i farmacisteve drejtues teknik ne Farmaci. Te dhenat e mesiperme jane gjeneruar me date 05.05.2025 Ne lidhje me numrin e farmacive qe kane kontrate me Fondin, drejtohuni prane Fondit pasi nuk e disponojme si informacion.</p> <p>Mund te na drejtoheni per cdo pyetje apo paqartesi qe mund te keni.</p>		
39.	Qershor	Nuk ka kerkesa per informacion				
40.	Korrik	Nuk ka kerkesa per informacion				
41.	Gusht	Nuk ka kerkesa per informacion				
42.	09.09.2025	Spitali Rajonal Gjirokastrë bazuar në Udhëzimin nr. 206, datë 09.04.2024 “Për	09.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije për sa më poshtë vijon:	E plotë	Ska tarifë

		<p>procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës të punonjësve të administratës në DQOSHKSH, DROSHKSH, NJVKSH dhe Drejtoritë e Shërbimit Spitalor në varësi të OSHKSH-së” është duke zhvilluar një procedurë konkursi për pozicion vakant Farmacist provizor. Për këtë pozicion vakant janë paraqitur dy kandidatura, bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 ["Për të drejtën e informimit" , i ndryshuar, Kërkojmë nga ana juaj një informacion nëse Z. dhe Znj. janë Anëtarë të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.</p>		<p>Z. __, i datëlindjes __, lindur në Gjirokastrë, është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë me Nr. regjistri __ dhe ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Znj. __, e datëlindjes __, lindur në Gjirokastrë, është anëtare e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë me Nr. regjistri __ dhe ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Duke ju falenderuar,</p>		
43.	10.09.2025	<p>Jam duke kërkuar informacion zyrtar pranë institucionit tuaj lidhur me statusin e anëtarit:</p> <p>1. Ju lutem të më informoni në sa farmaci ushtron funksionin e drejtuesit teknik z.</p>	15.09.2025	<p>Ne pergjigje te emailit tuaj, ju informojme qe Z. ____ ushtron funksionin e drejtuesit teknik vetem ne nje subjekt farmaceutik.</p> <p>Ne lidhje me subjektin farmaceutik te cilit i referoheni, me nipt M27413201K, rezulton qe prane Urdhrit te Farmacisteve te Shqiperise ky subjekt ka te regjistruara nje</p>	E plotë	Ska Tarifë

		<p>_____, me numër anëtarësie _____ pranë UFSH.</p> <p>2. Gjithashtu, ju bëj me dije se subjekti _____, me _____ NUIS M27413201K, rezulton të ketë në pronësi 4 farmaci në Sarandë. Nga verifikimet e mia te vertetuara po ashtu nga Sistemi i QKB, ai është i licensuar vetëm në njërin prej tyre, por aktiviteti farmaceutik ushtrohet në të katër farmacitë, me tabela dhe simbolet përkatëse të farmacisë (kryqet). Ju lutem të konfirmoni situatën ligjore në këtë rast dhe nëse është në përputhje me rregulloren e UFSH.</p> <p>Ky informacion më nevojitet për qëllime verifikimi dhe transparence. Ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunimin dhe pres përgjigjen tuaj zyrtarë bashkalidhur keni</p>		<p>farmaci ne Sarande me adrese Rruga Butrinti, Nd 22, Njesia nr 8 dhe nje ne Ksamil me adrese Rruga e Ksamilit, te pajisur me leje ushtrimi profesioni te drejutesit teknik, per secilin subjekt.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		kopje te dokumentacionit te licensimit te tyre				
44.	Tetor	Nuk ka kerkesa per informacion				
45.	18.11.2025	<p>Emri im është _____, farmacist e licencuar nga [Syria], dhe aktualisht banoj në Shqipëri. Po ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacion në lidhje me procedurat zyrtare që duhen ndjekur për njohjen ose ekuivalentimin e diplomës sime të farmacisë dhe kualifikimeve profesionale, me qëllim punësimin si farmacist në Tiranë.</p> <p>Do të doja të informohesha veçanërisht për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentet e nevojshme për procesin e njohjes ose ekuivalentimit të diplomës. 2. Nëse aplikimi duhet të dorëzohet përmes një platforme të caktuar apo fizikisht. 	18.11.2025	<p>Ne lidhje me ekuivalentimin e diplomes ju lutem drejtohuni prane Qendres se Sherbimeve Arsimore.</p> <p>Bazuar ne nenin 6 te Statutit te Urdhrit te Farmacisteve te Shqiperise, (te cilin e egjeni ne faqen zyrtare te UFSH-se www.ufsh.org.al, ne rubriken legjislacioni) “Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të farmacistit në sektorin farmaceutik të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të antarësohen në Urdhër, të njohin dhe të zbatojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin farmaceutik dhe atë shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin dëshminë e provimit të kualifikimit në gjuhën shqipe nga institucionet përkatëse të licensuara dhe të njohura nga Ministria e Arsimit si dhe ti nënshtrohet një testimi me gojë nga Komisioni i ngritur pranë Urdhrit të Farmacistëve. Këshilli Kombëtar i Urdhrit përcakton</p>	E plotë	Ska Tarifë

		<p>3. Kërkesat gjuhësore ose provimet profesionale që duhet të plotësohen.</p> <p>4. Kohëzgjatjen e pritshme të procesit dhe tarifat përkatëse.</p> <p>Do t'ju isha shumë mirënjohëse për çdo udhëzim apo link të dobishëm që mund të më ndihmojë të përfundoj me sukses hapat e nevojshëm.</p> <p>Ju falënderoj sinqerisht për kohën dhe bashkëpunimin. Pres me kënaqësi përgjigjen tuaj.</p>		<p><i>kriteret për pranimin e farmacistëve në Urdhër”.</i></p> <p>Dokumentacionin e nevojshëm për anetaresim në Urdhër e gjeni në linkun e mëposhtem:</p> <p>https://www.ufsh.org.al/frontend/assets/pdf/anetaresimi/Dokumentacioni_i_nevojshem_per_anetaresim_per_shtetasit_e_huaj.pdf</p> <p>Duke ju falënderuar,</p>		
46.	30.11.2025	<p>Pershendetje</p> <p>Me duhet nje informacion ne lidhje me akreditimin.Ne momentin kur duhet te bej ricertifikim sa kredite duhet te kem ne total nese kam qendruar 1.5 vjeter I papunesuar ai farmacist . Me duhen Po 75 kredite apo me pak ? Mund</p>	02.12.2025	<p>Përsëndetje,</p> <p>Në përfundim të ciklit, totali i krediteve të detyrueshme duhet të jetë 75 kredite. Ju informojmë se, nëse gjatë një viti kalendarik keni një shkëputje më të gjatë se 4 muaj, atëherë nga detyrimi vjetor i krediteve do t'ju zbriten 15 kredite.</p> <p>Gjithë të mirat,</p>	E plotë	Ska Tarifë

		te me jepni nje informacion? Faleminderit!				
47.	19.12.2025	Pershendetje, ju kontaktoj nga agjenci farmaceutike _____ Kam nje pyetje, kreditet i kam plotesuar por nuk e di proceduren si ngarkohen online, kam certifikatat e trajnimeve. Me respekt,	19.12.2025	Pershendetje, Hyni ne e-Albania dhe kerkoni “Aplikim mbi statusin e certifikimit”, plotesoni te dhenat ne rubrikat perkatese dhe sipas kategorise konference/trajnim ngarkoni dokumentat perkatese. Gjithe te mirat!	E plotë	Ska Tarifë
48.	14.01.2026	I/E nderuar Zonjë/Zotëri, Ju shkruaj për të kërkuar informacion lidhur me procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për njohjen dhe marrjen e titullit të farmacistit në Republikën e Shqipërisë. Kam përfunduar studimet e mia universitare në fushën e farmacisë në Gjermani dhe do të doja të informohesha mbi hapat që duhet të ndjek për të ushtruar profesionin e farmacistit në Shqipëri.	15.01.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se, referuar nenit 8 të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, për të fituar të drejtën për të ushtruar një profesion të rregulluar në Shqipëri, çdo kandidat duhet të plotësojë këto kushte: a) të kryejë praktikën profesionale; b) të kryejë provimin e shtetit; c) të regjistrohet në urdhrin profesional përkatës. Fillimisht, duhet të kryeni procedurën e njësimit të diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA). Në rast se diploma juaj njihet në nivelin	E plotë	Ska Tarifë

		<p>Konkretisht, do të isha mirënjohëse nëse mund të më informoni mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Dokumentacionin e nevojshëm për aplikim -Procedurën e njohjes së diplomës së huaj -Nëse kërkohet provim shtetëror, praktikë profesionale apo trajnim shtesë -Afatet kohore dhe institucionet përkatëse ku duhet të drejtohem -Sa sezone ne vit ka për të dhene provimin e shtetit dhe kur janë ato. <p>Gjithashtu, do të doja të pyesja nëse do të ishte e mundur të paraqitesha personalisht pranë institucionit tuaj për të marrë informacion më të detajuar dhe për të dorezuar dokumentat.</p> <p>Do të isha e disponueshme në njërin nga këto data: 29.01.2026, 30.01.2026 ose 02.02.2026, nëse ndonjë prej tyre është e përshtatshme për ju.</p>		<p>“Master i Shkencave në Farmaci”, mund të vijoni më tej me procedurat për anëtarësim pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.</p> <p>Nëse provimin e shtetit e keni kryer në Gjermani, duhet të paraqisni dokumentacionin përkatës që vërteton kryerjen e këtij provimi, të përkthyer në gjuhën shqipe, të noterizuar dhe të pajisur me vulë apostile. Datat e regjistrimit për Provimin e Shtetit përcaktohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Për sezonin e ardhshëm, regjistrimet do të zhvillohen në periudhën 20 janar 2026 – 25 janar 2026.</p> <p>Në rast se nuk keni kryer as praktikën profesionale dhe as provimin e shtetit në Gjermani, pas përfundimit të njësimit të diplomës, duhet të paraqiteni për regjistrim për praktikë profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve. Sezoni i radhës për regjistrimin e praktikës profesionale zhvillohet në muajin korrik. Për informacion më të detajuar mbi afatet dhe procedurat, ju rekomandojmë të ndiqni faqen zyrtare të UFSH-së: www.ufsh.org.al</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>Nëse dispononi udhëzime zyrtare ose materiale informuese, do ta vlerësoja shumë nëse do të mund t'i ndani me mua.</p> <p>Ju falënderoj paraprakisht për kohën dhe ndihmën tuaj dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj.</p>		<p>Dokumentacionin e nevojshëm për anëtarësim në Urdhri e Farmacistëve mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://www.ufsh.org.al/frontend/assets/pdf/anetaresimi/per-antaresim-ne-ufsh.pdf</p> <p>Mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo sqarim shtesë.</p>		
49.	19.01.2026	<p>I nderuar Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë,</p> <p>Ju shkruaj për të kërkuar informacion dhe udhëzim zyrtar lidhur me procedurën që duhet të ndjek në situatën time.</p> <p>Kam përfunduar studimet në Farmaci dhe kam dhënë Provimin e Shtetit në Republikën e Shqipërisë në vitin 2014. Në atë periudhë, për arsye personale, nuk kam kryer stazhin profesional.</p> <p>Aktualisht ndodhem jashtë Shqipërisë, por planifikoj të shpërngulem dhe të kthehem në Shqipëri pas disa muajsh me qëllim</p>	21.01.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Nga verifikimi rezulton që jeni diplomuar pranë Universitetit Kristal. Fillimisht duhet të paraqiteni pranë Arkives Qendrore për të marrë një kopje të regjistrit (pasi shumë diploma të ish Universitetit Kristal kanë rezultuar me problem dhe është bërë një verifikim i tyre), dhe me pas nëse të dhenat tuaja në diplomë perputhen me të dhenat tuaja në regjister, mund të vijoni me procesin e anetaresimit.</p> <p>Pervoja e punës për të bërë drejtues teknike në farmaci, nëse i referoheni kësaj me termin stazh, vazhdon të jetë tre vite eksperience pune me kohe të plote në farmaci.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>	E plotë	Ska Tarifë

		<p>ushtrimin e profesionit të farmacistit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Ju lutem, do të vlerësoja shumë nëse mund të më informoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nëse duhet të kryej stazhin profesional 1-vjeçar sipas ligjit aktual, - procedurën e regjistrimit për stazh, - si dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të përgatis paraprakisht. <p>Ju falënderoj paraprakisht për kohën dhe ndihmën tuaj dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj me shkrim.</p>				
50.	26.01.2026	<p>Përshëndetje, Jam farmacist e licencuar dhe aktualisht e kam licencën të pezulluar/blokuar, me qëllim riaktivizimin e saj në të ardhmen nëse ndonjëhere vendos të rikthehem në profesion.</p>	03.02.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Në momentin që ju do vendosni te riktheheni, Ju duhet te kryeni procesin e ricertifikimit dhe duhet te beni njekohesisht aplikim dhe per ndryshim vendi pune.</p>	E plotë	Ska Tarifë

		<p>Aktualisht jetoj jashtë vendit dhe nuk jam në marrëdhënie pune si farmacistë. Do të dëshiroja të merrja informacion të saktë lidhur me kushtet për riaktivizimin e licencës, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A kërkohet plotësimi i krediteve të edukimit në vazhdim edhe gjatë periudhës kur licenca është e pezulluar? - Nëse po, si mund të plotësohen këto kredite duke qenë jashtë vendit? - Cilat janë hapat dhe dokumentacioni i nevojshëm për riaktivizimin e licencës në rast se në të ardhmen vendos të rikthehem në ushtrimin e profesionit? <p>Ju falënderoj paraprakisht për ndihmën dhe pres me interes udhëzimet tuaja.</p>		<p>Me poshte po ju dergoj listen e dokumentacionit te nevojshem per ricertifikim dhe per ndryshim vendi pune. Dokumentacioni i cili eshte i perfshire ne te dy listat do te dorezohet vetem njehere.</p> <p>https://www.ufsh.org.al/storage/membership/1767653999_Dokumentacioni_I_Nevojsh_m_Per_Ricertifikim_1_.pdf</p> <p>https://www.ufsh.org.al/storage/membership/1767654178_nga-i-punsuar.pdf</p> <p>Gjatë periudhës që nuk keni qenë në marrëdhënie pune dhe leja ka qenë e pezulluar, nuk keni nevojë për kredite. Megjithatë, duhet të keni të plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve deri në momentin kur keni qenë në marrëdhënie pune dhe leja juaj ka qenë aktive.</p> <p>Gjithe te mirat!</p>		
51.	02.03.2026	Kërkohen të dhëna sipas tabelës	12.03.2026	Venia ne dispozicion e të Dhënave sipas tabelës	E plotë	Ska Tarifë

				<p>Të dhëna nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë</p> <table border="0"> <tr> <td></td> <td colspan="4" style="text-align: center;">Viti</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">2022</td> <td style="text-align: center;">2023</td> <td style="text-align: center;">2024</td> <td style="text-align: center;">2025</td> </tr> </table> <p>Nr. e farmacistëve të licencuar që kanë përfunduar studimet në UMT</p> <table border="0"> <tr> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">99</td> <td style="text-align: center;">26</td> <td style="text-align: center;">44</td> <td></td> </tr> </table> <p>Shkalla e kalueshmerisë në provimin e licencës për secilin vit (numrin e kandidateve pjesëmarrës kundrejt numrit të kandidatëve që kane rezultuar kalues)</p> <table border="0"> <tr> <td style="text-align: center;">-----</td> <td style="text-align: center;">-----</td> <td style="text-align: center;">-----</td> <td style="text-align: center;">-----</td> <td></td> </tr> </table> <p>-----</p> <p>Të dhëna krahasuese të kalueshmërisë midis të diplomuarve UMT dhe atyre nga institucione private të arsimit të lartë (nëse disponohen)</p> <table border="0"> <tr> <td style="text-align: center;">-----</td> <td style="text-align: center;">-----</td> <td style="text-align: center;">-----</td> <td></td> </tr> </table> <p>-----</p> <p>Të dhëna të përgjithshme lidhur me punësimin e farmacistëve të licensuar (psh. përqindja e të punësuarve, sektori i punësimit: publik/privat, etj.) (Këto të dhëna i referohen numërit të farmacistëve të licencuar që kanë përfunduar studimet në UMT në vitet e mësipërme, pa u llogaritur me përqindje)</p> <table border="0"> <tr> <td style="text-align: center;">35 Aktiv</td> <td></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">5 Pasiv</td> <td></td> </tr> </table> <hr style="width: 10%; margin-left: 0;"/> <table border="0"> <tr> <td style="text-align: center;">35 Privat</td> <td></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">0 Publik</td> <td style="text-align: center;">87 Aktiv</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">12 Pasiv</td> <td></td> </tr> </table>		Viti					2022	2023	2024	2025	40	99	26	44		-----	-----	-----	-----		-----	-----	-----		35 Aktiv		5 Pasiv		35 Privat		0 Publik	87 Aktiv	12 Pasiv			
	Viti																																							
	2022	2023	2024	2025																																				
40	99	26	44																																					
-----	-----	-----	-----																																					
-----	-----	-----																																						
35 Aktiv																																								
5 Pasiv																																								
35 Privat																																								
0 Publik	87 Aktiv																																							
12 Pasiv																																								

				<hr/> 84 Privat 3 Publik 26 Aktiv 0 Pasiv <hr/> 26 Privat 0 Publik 71 Aktiv 3 Pasiv <hr/> 71 Privat 0 Publik Nr. i farmacistëve që kanë kërkuar dokumentacion apo certifikata "good standing" për të ushtruar profesionin jashtë vendit 75 64 43 46 Bashkia Nr. i të diplomuarve UMT (2022-2025) që ushtrojnë profesionin e farmacistit sipas bashkive Nr. i të gjithë farmacistëve që ushtrojnë profesionin sipas bashkive Tiranë 168 - Aktiv 13 - Pasiv 1733 Durrës 2 – Aktiv 0 - Pasiv 309 Elbasan 9 - Aktiv 0 - Pasiv 202		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>Shkodër 9 – Aktiv 1 – Pasiv 159 Lezhë 10 – Aktiv 0 - Pasiv 102 Dibër 2 – Aktiv 0 - Pasiv 49 Kukës 3 – Aktiv 0 - Pasiv 30 Vlorë 6 – Aktiv 1 - Pasiv 123 Korçë 8 – Aktiv 0 - Pasiv 137 Fier 14 – Aktiv 0 - Pasiv 231 Gjirokastrë 4 – Aktiv 2 – Pasiv 81 Berat 4 - Aktiv 1 - Pasiv 63</p> <p>Legjenda: Aktiv – Farmacistë që ushtrojnë profesionin e farmacistit aktualisht, në sektorin publik ose privat Pasiv – Farmacistë që nuk ushtrojnë profesionin e farmacistit aktualisht</p>		
52.	04.03.2026	Interesohem per informacion ne lidhje me punesim si farmaciste, e Kam mbaruar universitetin prane Albanian University 2011-2016. E Kam marre	04.03.2026	Duke qenë se keni më shumë se 5 vite shkëputje nga ushtrimi i profesionit, duhet të regjistrohesh pranë UFSH për t'iu nënshtruar praktikës profesionale me kohëzgjatje 3 muaj.	E plotë	Ska Tarifë

		<p>provimin e shtetit si farmacistë. Punova vetem 3 muaj ne profesion me pas dorezova dokumentacionin prane zyrave te Ufsh! Tani cfare me duhet per te vazhduar punen ne profesion ju lutem?</p>		<p>Pas përfundimit të praktikës, do t'i nënshtroheni provimit përkatës, i cili zhvillohet mbi bazën e legjislacionit në fuqi (jo provimi i VAP, që nënshtrohen student pas përfundimit të studimeve).</p> <p>Vetëm pas përmbushjes së këtyre detyrimeve, mund të paraqisni aplikimin për ndryshim vendi pune dhe për procesin e ricertifikimit.</p> <p>Për çdo informacion shtesë apo sqarim të mëtejshëm, mbetemi në dispozicionin tuaj</p>		
54.	20.04.2026	<p>Pershendetje, Po punoj per nje studim shkencor, ju lutem jam e interesuar te kem nje informacion, vit pas viti se - sa ka qene numri i farmacive ne tirane dhe ne secilin qark, - sa eshte numri i farmacisteve te licensuar vit pas viti ne tirane dhe ne qarqe, - sa eshte numri i drejtuesve teknike vit pas viti ne tirane dhe qarqe - sa eshte numri i studenteve te rregjistruar per praktiken dhe provimin</p>	30.04.2026	<p>Në vijim të kërkesës suaj për vënien në dispozicion të të dhënave, më poshtë po ju vendosim në dispozicion të dhënat që disponojmë:</p> <p>- sa ka qene numri i farmacive ne tirane dhe ne secilin qark</p> <p>Urdhri i Farmacistëve nuk bën regjistrimin e subjekteve farmaceutike por regjistron profesionistët farmacistë. Në lidhje me numrin e farmacive të licensuar drejtohuni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p> <p>- sa eshte numri i farmacisteve te licensuar vit pas viti ne Tirane dhe ne qarqe,</p> <p>Nga të dhënat që ne disponojmë, aktualisht numri i farmacistëve të</p>	E plotë	Ska Tarifë

		<p>e VAP vit pas viti, sa kane marre ate</p> <ul style="list-style-type: none"> - sa eshte numri i studenteve qe kane kaluar provimin e shtetit vit pas viti, te rregjistruar dhe qe kane mare provimin - sa eshte numri i farmacive me kontrate me Fondin ne Tirane dhe neper qarqe vit pas viti - sa jane numri i rrjeteve farmaceutike dhe sa farmaci ka secila prej tyre ne tirane dhe neper qarqe <p>Periudha vjetore 2020 - 2025</p>		<p>pajisur me leje ushtrimi profesioni në secilin qark është si mëposhtë:</p> <p>Berat 66, Diber 49, Durres 317, Elbasan 204, Fier 237, Gjirokaster 84, Korçë 141, Kukës 30, Lezhe 104, Shkoder 167, Tiranë 1889, Vlorë 133</p> <p>- sa eshte numri i drejtuesve teknike vit pas viti ne tirane dhe qarqe</p> <p>Numri i drejtuesve teknik në tiranë dhe në qarqe, (përfshirë farmaci, importues shpërndarës dhe prodhues farmaceutikë) është si mëposhtë:</p> <p>Berat 43, Diber 31, Durres 186, Elbasan 125, Fier 136, Gjirokaster 50, Korçë 83, Kukës 16, Lezhe 60, Shkoder 103, Tiranë 890, Vlorë 82</p> <p>- sa eshe numri i studenteve te rregjistruar per praktiken dhe provimin e VAP vit pas viti, sa kane marre ate</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për praktikën:</p> <p>2025 – 273; 2024 – 127; 2023 – 133; 2022 – 184; 2021 – 238; 2020 – 174</p> <p>Numri i praktikantëve të regjistruar në provimin e VAP</p> <p>2026 – 104; 2025 – 268; 2024 – 271; 2023 – 272; 2022 – 394; 2021 – 365; 2020 – 329</p> <p>- sa eshte numri i studenteve qe kane kaluar provimin e shtetit vit pas viti, te rregjistruar dhe qe kane mare provimin</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>Në lidhje me numrin e studentëve që kanë kaluar provimin e shtetit ju lutemi drejtohuni pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore pasi është institucioni që disponon këto të dhëna. Farmacistët regjistrohen pranë Urdhrit për të dhënë provimin e shtetit, dhe më pas paraqiten me vertetimin individual të kalimit me sukses të provimit, në momentin që dëshirojnë të anëtarësohen pranë UFSH. Qendra e Shërbimeve Arsimore nuk na vendos një listë totale të farmacitëve që kalojnë me sukses këtë provim.</p> <p>Kandidatët e regjistruar në provimin e shtetit sipas viteve: 2026 – 357; 2025 – 337; 2024 – 187; 2023 – 174; 2022 – 267; 2021 – 128; 2020 – 160</p> <p>Në lidhje me numrin e farmacive që kanë Kontratë me Fondin, Urdhri i Farmacistëve nuk disponon asnjë informacion, prandaj ju lutemi drejtohuni pranë këtij insitucioni.</p> <p>Dhe po ashtu në lidhje me numrin e rrjeteve farmaceutike, ashtu sikurse theksuam dhe më sipër, Urdhri i Farmacistëve nuk bën regjistrimin e subjekteve farmaceutike, prandaj për këtë informacion drejtohuni pranë QKB si institucioni përgjegjës për licencimin e subjekteve farmaceutike.</p>	
--	--	--	--	--	--

				Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm. Me respekt,		
--	--	--	--	--	--	--